

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Jorida Tabaku akuzon qeverinë: KAYO dhe institucionet e tjera, pjesë e një “arkipelagu paligjshmërie” të ndërtuar nga Rama
ADRESA	https://albeu.com/lajme/jorida-tabaku-akuzon-qeverine-kayo-dhe-institucionet-e-tjera-pje-se-e-nje-arkipelagu-paligjshmerie-te-ndertuar-nga-rama/1008030/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 08:18:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 08:17:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	99176d66fd839857c167119f2e4156d5121bcdcf25b059113bb38bbaf0eeb31b4
TEKSTI	45eaeb819d12f6498ccd9cab7adfb4dde686f776ad2cdeade46c295aed4daa36
PAMJA	8473cdc961fba77aeb3405c5443ccdc49a0d9d81a3173f6ae241d6c15969ba53

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	64a510c0157fa1d93b6334068d33c4145211d9f49d8ada427619316c42fc5da8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a37a19bd8769ebad3f30fd8502903a3868a0ddc6c817d6dbe0c66d76bad4893c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/64a510c0157fa1d93b6334068d33c4145211d9f49d8ada427619316c42fc5da8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Jorida Tabaku akuzon qeverinë: KAYO dhe institucionet e tjera, pjesë e një “arkipelagu paligjshmërie” të ndërtuar nga Rama



Deputetja e Partisë Demokratike Jorida Tabaku, ka ngritur akuza për mungesë transparence dhe kontrolli në disa prej strukturave shtetërore, duke përmendur KAYO-n, Bankën Shqiptare të Zhvillimit dhe Korporatën e Investimeve Shqiptare.

Sipas saj, këto struktura përbëjnë pjesë të një modeli ekonomik ku rreziku mbetet publik, ndërsa vendimarrja përqendrohet në pak duar.

Tabaku e cilëson KAYO-n si një nga “ishujt” e këtij sistemi, duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën e përzgjedhjes së partnerëve privatë dhe kontrollin mbi kostot, konfliktet e interesit dhe përfituesit fundorë.

Ajo thekson se fakti që bëhet fjalë për një sektor strategjik nuk duhet të përdoret si argument për mungesën e transparencës financiare.

“Sekreti shtetëror nuk mund të kthehet në sekret financiar. Siguria nuk mund të përdoret si perde për të fshehur mënyrën se si shpenzohen paratë e qytetarëve”, deklaroi Tabaku.

Përveç KAYO-s, Tabaku quan “ishull” edhe Bankën Shqiptare të Zhvillimit. Ajo pranon se Shqipëria ka nevojë për më shumë financim për bujqësinë, bizneset e vogla dhe sektorët që kanë vështirësi në aksesimin e kredive, por thekson se duhet kontroll i pavarur dhe transparencë mbi mënyrën se si përzgjedhen përfituesit.

Në fokusin e saj është edhe Korporata e Investimeve Shqiptare. Deputetja i referohet edhe gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përmendur problematikat në planifikimin e projekteve, mungesë metodologjish të standardizuara për përzgjedhjen dhe menaxhimin e tyre, analiza të paplota të rrezikut dhe përfitueshmërisë, si dhe një hua prej 2 miliardë lekësh që nuk ishte shlyer brenda afatit fillestar.

të fundit /



Përplasja në Korçë, ambulanca godet të moshuarin me biçikletë...



Tri kriteret që ndikojnë në përzgjedhjen e fituesit të Topit të Artë



Kamëz/ Shpërthim me lëndë plasëse në portën e një banese,...



U arratis në mënyrë spektakolare, ky është i burgosuri shqiptar në...



Elsaid Hysaj pa skuadër, mbrojtësi shqiptar propozohet ...



Koreja e Veriut kryen lëshime rakitore në Detin e Japonisë,...



Aksidenti i rëndë në Himarë/ Makina përmbysset në rrugë,...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e tij, ka evidentuar planifikim të pamjaftueshëm, mungesë metodologjish të standardizuara për përzgjedhjen dhe menaxhimin e projekteve, analiza të paplota të rrezikut dhe përfitueshmërisë, si edhe një hua prej 2 miliardë lekësh që nuk u shlye brenda afatit fillestar. Këto nuk janë etiketime politike. Janë gjetje që kërkojnë përgjigje. Sa projekte janë realizuar? Sa vende pune të qëndrueshme janë krijuar? Sa të ardhura ka marrë shteti? Si janë vlerësuar pronat publike? Kush mban përgjegjësi kur paguhen konsulenca, por projekti nuk ecën? Ku është analiza që provon se qytetari fiton më shumë sesa humbet?", thote Tabaku.

Jorida Tabaku:

Në këtë kënd të fundjavës dua të flasim për diçka që, në pamje të parë, duket larg jetës sonë të përditshme: për agjenci, korporata dhe shoqëri shtetërore me emra të mëdhenj, borde, drejtorë dhe statute. Por, në të vërtetë, kjo temë është shumë pranë çdo familjeje shqiptare, sepse lidhet me faturën që paguajmë në fund të muajit, me çmimin e ushqimeve, me librat dhe mjetet e shkollës së fëmijëve, me pagën që nuk mjafton, me taksat që paguajmë dhe shërbimet që nuk marrim. Në hartën e Shqipërisë është krijuar një realitet i ri ekonomik: disa institucione që duken si ishuj të veçuar, por që, kur i shikon së bashku, formojnë një arkipelag të tërë paligjshmërie, mungese transparence dhe pushteti të pakontrolluar. Një ishull quhet KAYO. Një tjetër quhet Banka Shqiptare e Zhvillimit. Një tjetër quhet Korporata e Investimeve Shqiptare. Emrat ndryshojnë, fushat ndryshojnë, por modeli mbetet i njëjtë: paratë janë publike, pasuritë janë publike, rreziku është publik, ndërsa vendimarrja përqendrohet në pak duar dhe kontrolli dobësohet. Ky është thelbi i problemit dhe kjo është ekonomia e pakicës, faturën e së cilës e paguan shumica.

Ky sistem nuk u ngrit brenda një nate. Ai u ndërtua hap pas hapi gjatë këtyre trembëdhjetë viteve. Filloi me mikromenaxhimin e tenderëve, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private. Nga blerjet më të vogla deri te kontratat më të mëdha në shëndetësi, energji apo trajtimin e mbetjeve, u konsolidua ideja se nuk mjafton të kesh ofertën më të mirë; duhet të jesh pranë pushtetit. Sipërmarrësi i ndershëm filloi të kuptonte se puna, ideja dhe investimi nuk mjaftojnë kur rezultati vendoset nga lidhja politike. Më pas sistemi evoluoi. Nuk mjaftonte më kontrolli i një tenderi. U krijuan struktura të posaçme, me ligje të posaçme dhe përjashtime të posaçme. Ishuj ku rregullat e zakonshme të shtetit zbatohen pjesërisht, ku Parlamenti sheh më pak, publiku di më pak dhe qeveria vendos më shumë. Sot nuk kemi përballë vetëm raste të veçuara. Kemi një arkitekturë.

Le ta shohim ishullin e parë: KAYO-n. KAYO u krijua si shoqëri shtetërore dhe, në një kohë shumë të shkurtër, u bë pjesë e një vargu shoqërisht të përbashkëta me kompani private. Këto partneritete prekin prodhimin e mjeteve, uniformave, municioneve dhe teknologjive ushtarake. Pra, kemi fonde publike, prona shtetërore, kontrata në një sektor strategjik dhe partnerë privatë. Atëherë pyetjet janë të pashmangshme: Si u përzgjedh secili partner? Çfarë gare u zhvillua? Si u vlerësua përvoja e tyre? Kush i kontrollon kostot? Kush verifikon konfliktin e interesit? Ku publikohen kontratat dhe përfituesit fundorë? Çfarë përgjegjësie mban bordi për çdo euro të shpenzuar? Këto pyetje nuk e dëmtojnë sigurinë kombëtare. Përkundrazi, e mbrojnë atë. Sekretet shtetërorë nuk mund të kthehet në sekret financiar. Siguria nuk mund të përdoret si perde për të fshehur mënyrën se si shpenzohen paratë e qytetarëve. Ne nuk kundërshtojmë prodhimin shqiptar. Ne kundërshtojmë privatizimin e përfitimit dhe shtetëzimin e rrezikut. Kundërshtojmë një model ku privati merr kontratën, ndërsa qytetari mban faturën nëse projekti dështon.

Ishulli i dytë është Banka Shqiptare e Zhvillimit. Edhe këtu duhet të jemi të qartë: Shqipëria ka nevojë për më shumë financim për bujqësinë, ndërmarrjet e vogla dhe sektorët që bankat tregtare i mbështesin pak. Ideja e një banke zhvillimi, në vetvete, nuk është e gabuar. Problemi është se kush e kontrollon, si i zgjedh përfituesit dhe kush paguan kur kreditë nuk kthehen. Ligji parashikon auditim të jashtëm dhe një rol të Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen e produkteve të kursimit të mbledhura përmes një entiteti të Postës Shqiptare, si edhe për raportimin statistikor. Por kjo nuk është e njëjta gjë me mbikëqyrjen e plotë dhe të zakonshme që ushtrohet mbi një bankë tregtare. Pra, qeveria është aksionare, qeveria zgjedh drejtimin, qeveria përcakton prioritetet dhe raporti i shkon sërish qeverisë. Pikërisht këtu lind nevoja për një kontroll realisht të pavarur, sepse një bankë zhvillimi mund të jetë motor për sipërmarrjen, por, pa filtra profesionalë, mund të kthehet në sportel për klientët politikë. Mund të financojë fermerin që prodhon ose mikun që telefonon. Mund të ndihmojë biznesin me ide ose biznesin me lidhje. Prandaj kërkojmë që çdo kredi e madhe, çdo garanci shtetërore, çdo përfitues dhe çdo ekspozim fiskal të jenë të kontrollueshme dhe, kur nuk ka pengesë ligjore, publike. Zhvillimi nuk ka frikë nga transparenca. Vetëm favori ka frikë prej saj.

Ishulli i tretë është Korporata e Investimeve Shqiptare. Këtu kontrasti është tronditës. Një bashki, një shkollë apo një institucion nuk mund të blejë as një kuti stilolapsash pa procedurë. Por, kur flasim për toka, godina dhe asete publike me vlerë miliona euro, standardi bëhet më i megjullt. Pasuritë i transferohen një korporate dhe vendimarrja përqendrohet në një strukturë shumë më pak të dukshme për qytetarin. Pyetja është e thjeshtë: Pse sa më e madhe vlera, aq më e vogël e transparencës? Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e tij, ka evidentuar planifikim të pamjaftueshëm, mungesë metodologjish të standardizuara për përzgjedhjen dhe menaxhimin e projekteve, analiza të paplota të rrezikut dhe përfitueshmërisë, si edhe një hua prej 2 miliardë lekësh që nuk u shlye brenda afatit fillestar. Këto nuk janë etiketime politike. Janë gjetje që kërkojnë përgjigje. Sa projekte janë realizuar? Sa vende pune të qëndrueshme janë krijuar? Sa të ardhura ka marrë shteti? Si janë vlerësuar pronat publike? Kush mban përgjegjësi kur paguhen konsulenca, por projekti nuk ecën? Ku është analiza që provon se qytetari fiton më shumë sesa humbet?

Edhe projekti "Durana Tech Park" duhet parë me këtë standard. Inovacioni është i domosdoshëm. Lehtësitë fiskale mund të kenë kuptim kur sjellin investime të reja, teknologji dhe punësim cilësor. Por, kur kompanitë marrin privilegje fiskale, qytetarët kanë të drejtë të dinë kriteret, koston për buxhetin dhe rezultatin real në terren. Këta tre ishuj nuk janë të shkëputur. Ata lidhen nga të njëjtat ura: ligje të posaçme, vendimarrje e përqendruar, kufizim i garës, kontroll i pamjaftueshëm dhe rrezik që përfundon te taksapaguesi. Dhe kjo është arsyeja pse kjo temë prek drejtpërdrejt koston e jetesës. Kur shteti zgjedh favorin dhe jo garën, paguan më shumë për të njëjtin mall apo shërbim. Kur biznesi pa lidhje përjashtohet, tregu humbet operatorë dhe konkurrenca dobësohet. Kur

ndërmarrja shtetërore ka tokë falas, garanci publike dhe kontrata nga shteti, sipërmarrësi privat nuk konkurren më në kushte të barabarta.

Korrupsioni nuk është një koncept abstrakt. Korrupsioni është taksë e fshehtë mbi çdo familje. E paguajmë te çmimi, te shërbimi i munguar dhe te mundësia e humbur. Kjo është arsyeja pse një ekonomi mund të rritet në statistika, ndërsa familja ndihet më e varfër. Çfarë duhet bërë? Së pari, çdo kontratë, partneritet dhe transferim i pasurisë publike duhet të bëhet publik, së bashku me kriteret e përzgjedhjes, vlerësimin ekonomik dhe përfituesit fundorë. Së dyti, çdo shoqëri shtetërore që përdor fonde, prona apo garanci publike duhet t'i nënshtrohet kontrollit të plotë të Kuvendit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera të pavarura. Së treti, bordet dhe drejtuesit duhet të mbajnë përgjegjësi personale për çdo vendim, çdo kontratë dhe çdo euro të shpenzuar. Së katërti, duhet të rikthehet konkurrenca reale dhe e barabartë. Sipërmarrësi duhet të fitojë nga puna, ideja dhe aftësia, jo nga lidhja me pushtetin.

Ne nuk mund të ndërtojmë një ekonomi të fortë mbi ishuj përjashtimesh. Nuk mund të kemi një ligj për qytetarin dhe një tjetër për të privilegjuarin. Nuk mund të kërkojmë nga biznesi i vogël çdo faturë dhe çdo dokument, ndërsa miliarda euro kalojnë në struktura ku transparencja është minimale. Nuk mund të flasim për integritet europian, ndërsa krijojmë institucione që largohen nga standardet europiane të konkurrencës, kontrollit dhe llogaridhënies. Shqipëria ka nevojë për institucione që i shërbejnë publikut, jo për struktura që mbrojnë pushtetin. Ka nevojë për një ekonomi që shpërblen punën, jo afërsinë politike. Ka nevojë për një shtet që mbron taksapaguesin, jo një shtet që i kalon atij faturën e dështimeve dhe abuzimeve.

Këta tre ishuj janë vetëm pjesë e një arkipelagu shumë më të madh. Një arkipelag i ngritur mbi ligje të posaçme, kontrata të mbyllura, favore dhe mungesë kontrolli. Një arkipelag që po dëmton konkurrencën, po dobëson ekonominë dhe po rëndon jetën e çdo familjeje shqiptare. Ky sistem nuk ndryshon duke larguar disa njerëz dhe duke sjellë disa të tjerë. Duhet të ndryshojë vetë mënyra e qeverisjes. Synimi ynë nuk është zëvendësimi i një grupi me një tjetër, por qeverisja për Shqipërinë dhe për qytetarët e saj. Ky sistem duhet ndryshuar. Jo për të zëvendësuar klientët e një partie me klientët e një partie tjetër, por për t'i dhënë fund vetë klientelizmit. Jo për të ndërruar emrat mbi zyra, por për të ndryshuar rregullat brenda tyre.

Shqiptarët meritojnë një shtet që jep llogari. Meritojnë një ekonomi që punon për shumicën dhe jo për pakicën. Meritojnë që taksat e tyre të përdoren për shkolla, spitale, rrugë dhe shërbime, jo për struktura të mbyllura dhe interesa të privileguara. Ne do të luftojmë për ta zhbërë këtë arkipelag pandëshkueshmërie dhe për të ndërtuar një kontinent ligjsh të barabarta, institucionesh të kontrolluara dhe mundësish për të gjithë. Sepse Shqipëria nuk është pronë e pushtetit. Shqipëria është e qytetarëve të saj. Dhe ekonomia e saj duhet të punojë për shumicën, jo për pakicën.

Shtuar më 12.09.2026 10:17

Tags: [akuza](#), [jorida tabaku](#), [KAYO](#), [rama](#)



Kamëz/ Shpërthim me lëndë plasëse në portën e një banese, zbulohet emr...




U arratis në mënyrë spektakolare, ky është i burgosuri shqiptar në Greqi



Aksidenti i rëndë në Himarë/ Makina përbyset në rrugë, raportohet për tre...



Arratisje spektakolare si në filma në Greqi, i burgosuri shqiptar i ikën policisë gj...



Njihuni me parashikimin e motit 12 Shtator 2026/ Reshje shiu në të gjithë...



Dita e 105-të e protestës kombëtare, diaspora zbret në shesh! Qytetarët...



Erion Braçe në "Praninë Besnike": Banorët e lagjes Irfan Tomnini i treguan...



Rama për Arben Ahmetajn: Kisha mbështetur një "maskë karnavalesh", jo ...



Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.